



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)  
Nr./Br./No 182 Nr. i faq./Br.str/No.pg 61  
Data/Datum/Date 30/01/2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 17 paragrafi 1 shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.1 dhe nenit 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, lidhur me nenin 10 paragrafi 2 pika 2.1, nenit 11 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013”), Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinorë, Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratim të Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit 2023 – 2031 me Nr. Prot. 6274/23 i datës 08.12.23 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017 dhe shkresës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr. 7479/23 të datës 05.01.24, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.01.2024 merr këtë:

## V E N D I M

### Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023-2031

#### Neni 1

**MIRATOHET** “Plani Zhvillimor Komunal” për Komunën e Rahovecit për periudhën 8 (tetë) vjeçare 2023-2031 (në tekstin e mëtejshëm PZHK), si një dokument-plan multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Rahovecit me sipërfaqe prej 275.89 km<sup>2</sup>.

#### Neni 2

**2.1.** “Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit 2023-2031” përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës, mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit.

**2.2.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është “Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit 2023-2031” i hartuar nga Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013”), Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinorë dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratim të Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit 2023 – 2031 me Nr. Prot. 6274/23 i datës 08.12.23 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë.

**2.3.** “Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit 2023-2031” përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, Raportin e vlerësimit strategjik mjedisor me Nr. Prot. 6487-2/19 i datës 16.12.2019 dhe Raportet e shqyrtimit publikë që janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Rahovecit, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

### Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 162/23 i datës 15.12.2023 dhe vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013.

#### *Vendimi u dërgohet:*

- *MAPL-së,*
- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorëve të Drejtorive,*
- *Shërbimit të Kuvendit, dhe*
- *Arkivit.*

## KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.182/24  
Datë:30.01.2024

